

Inspektori i Lartë i Drejtësisë

BULETINI MUJOR

Nr.11

DHJETOR 2021



INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË BËHET PJESE E RRJETIT EVROPIAN TË SHËRBIMEVE TË INSPEKTIMIT TË DREJTËSISË

Inspektori i Lartë i Drejtësisë është tashmë zyrtarisht pjesë e Rrjetit Evropian të Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë, me statusin e vëzhguesit.

Vendimi është marrë në mënyrë unanime në mbledhjen e datës 10 dhjetor 2021 të këtij Rrjeti, i konceptuar për të patur në përbërje, vetëm shtetet anëtare të Bashkimit Evropian.

Bashkëpunimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me Rrjetit Evropian të Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë nisi konkretisht në muajin Nëntor të këtij viti, me një vizitë zyrtare të tre përfaqësuesve të tij, nga Inspektoratet e Drejtësisë të Rumanisë, Portugalisë e Francës, mbështetur nga projekti i Këshillit të Evropës SEJ III dhe paralelisht një trajnim dy ditor ku inspektorë magjistratë nga Franca, Italia e Rumania, u paraqitën inspektorëve dhe ndihmës inspektorëve të ILD-së, praktikant më të mira të inspektimeve gjyqësore nga Inspektoriatet Europiane të Drejtësisë.



ILD
INSPEKTORI I LARTË
I DREJTËSISË

ILD NË TWITTER

I luntur dhe i nderuar që #INSPEKTORI I LARTË I DREJTËSISË është zyrtarisht pjesë e Rrjetit Evropian të Shërbimeve të Inspektimit të Drejtësisë si mbikëqyrës. I kënaqur të punoj me homologët e vendeve anëtare të Bashkimit Evropian mbi praktikant më të mira të inspektimit të magjistratëve dhe për shumë më tepër. #ILD #HJ #RESIJ



Ankimimi në ILD

Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë vijon me intensitet punën për konfirmimin e ankesave të mbartura e atyre të administruara që prej 1 Shkurtit 2020, kur u ngrit si institucion.


Për të lehtësuar këtë proces për personat e interesuar, ILD ka të publikuar në faqen zyrtare një formular të posaçëm ankesë, i cili:

- ⇒ mund të plotësohet direkt dhe dërgohet online;
- ⇒ të shkarkohet, plotësohet e dërgohet me email në info@ild.al
- ⇒ ose me postë në adresën Bulevardi “Dëshmorët e Kombit”, Godina nr.13, Tiranë.
- ⇒ mund të plotësohet pranë Zyrës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë, në rast nevojë, me asistencën e ekipit të zyrës së ankesave.

Pas marrjes së ankesës, Inspektori i Lartë i Drejtësisë Brenda 5

ditëve konfirmon me shkresë marrjen e saj.

Kriteret e pranueshmërisë së ankesës gjenden të publikuara në faqen zyrtare të ILD-së www.ild.al, në seksionin “Si pranohen ankesat”.



“Angazhimi kryesor i institucionit të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë është ushtrimi i funksioneve gjyqësore në Republikën e Shqipërisë në mënyrë sa më të pavarur, të paanshme dhe me integritet nëpërmjet një sistemi përgjegjshmërie dhe llogaridhënieje”

DHJETORI I ILD NË SHIFRA

83 vendime arkivimi, nga të cilat 76 vendime pas shqyrtimit fillestar, 7 vendime arkivimi pas verifikimit (5 vendime arkivimi pas verifikimit nga dosje të mbartura nga KLD dhe 2 vendime arkivimi pas verifikimit nga ankesa të ardhura në ILD);

16 vendime verifikimi;

1 vendim për fillim hetimi disiplinor;

1 kërkesë për procedim disiplinor.

STATISTIKA


Gjatë muajit **Dhjetor**, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka administruar **128 ankesa** të cilat janë paraqitur nga qytetarë dhe institucione.

Konkretisht:

121 ankesa janë depozituar nga qytetarët; **7 ankesa** janë përcjellë nga institucionet për kompetencë; **39 telefonata** me qytetarë, të cilët kanë kërkuar informacion mbi fazën e ankesave të tyre ose informacion mbi plotësimin e formularit TIP të ankesës; **16 takime** me ankues. Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka kryer konfirmimin

standard të marrjes së ankesës për të gjitha ankesat, që kanë hyrë për herë të parë në institucion, gjatë muajit Dhjetor 2021.

Ankesat që kanë subjekt të tyre prokurorë dhe gjyqtarë janë shpërndarë tek Inspektorët dhe ndodhen në faza të ndryshme, si shqyrtim fillestar, arkivim, verifikim, me projektvendimet përkatëse.



SEKTORI I ANKESAVE

Sektori i ankesave në ILD është përgjegjës për garantimin e të drejtës së informimit të qytetarëve dhe transparencën ndaj publikut. Ky sektor ndjek gjurmueshmërinë e ankesave në sistem dhe jep përgjigje për ankuesit, mbi fazën ku ndodhet ankesa e tyre.

Në kuadër të transparencës, për një komunikim të shtuar me qytetarët e interesuar, krahas faqes dhe adresës zyrtare, Zyra e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ka vënë në dispozicion numrin e telefonit +355 4 2217217.



KLJGJ PRANON KËRKESËN E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË PËR PROCEDIM DISIPLINOR NDAJ MAGJISTRATES P.F.

Këshilli i Lartë Gjyqësor pranoi kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për masë disiplinore ndaj gjyqtares së Elbasanit, P.F.

Në shpallje të vendimit, kryetarja Naureda Llagami tha se KLGJ vendosi pranimin e kërkesës së ILD-së dhe caktimin ndaj magjistrates të masës disiplinore ulje e pagës në masën 20% për një periudhë prej 6 muajsh. Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka finalizuar hetimin disiplinor ndaj magjistrates P.F. me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Elbasan, bazuar në praktikën e nisur ndaj magjistrates në vitin 2017 nga Inspektoriati i KLD-së (pas publikimit disa fakteve të transmetuara në emisionin investigativ “STOP” të TV Klan, më 31.01.2017) dhe e përcjellë, me kërkesë të ILD-së nga Ministria e Drejtësisë dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor.


Në përfundim, në analizë të fakteve raporti i hetimit i ILD konkludoi se nga ana e magjistrates subjekt hetimi disiplinor janë ndërmarrë veprime, që përbëjnë një mospërbushje të rregullt të detyrës, në

shkelje të rregullave të solemnitetit, të sjelljes në marrëdhënie me palët në proces, si dhe komunikimit ex parte të gjyqtares me dy persona, të prezantuar si familjarë të të pandehurit.

Pavarësisht eksperiencës së gjatë të saj në detyrë, gjyqtarja ka cënuar parimin e panshmërisë në gjykim, duke krijuar perceptimin e një zgjidhje pozitive për çështjen dhe jo për zgjidhjen e drejtë të saj.

Si pasojë e veprimeve të kryera nga ana e magjistrates është cënuar prestigji i figurës së gjyqtarit, si dhe është cënuar besimi i publikut të drejtësia. Besimi i publikut dhe respekti për gjyqësorin janë garanci të demokracisë dhe stabilitetit në një shoqëri demokratike.

Në konkluzionet e paraqitura gjatë seancës dëgjimore në KLGJ, Inspektori i Lartë i Drejtësisë kërkoi marrjen e masës disiplinore ulje e përkohshme e pagës në masën 40% për një periudhë 6 mujore.



KLP PRANON KËRKESËN E INSPEKTORIT TË LARTË TË DREJTËSISË PËR SHKARKIMIN NGA DETYRA TË MAGJISTRATIT SH.K.

Këshilli i Lartë i Prokurorisë pranoi sot kërkesën e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për procedim disiplinor me masën “shkarkim nga detyra”, për magjistratin SH.K., të prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Pogradec për shkelje të rënda profesionale, që diskretitojnë pozitën dhe figurën e prokurorit. Hetimi disiplinor ndaj magjistratit SH.K. ka nisur pas një informacioni të Prokurorit të Përgjithshëm për shkelje procedurale gjatë veprimtarisë hetimore, përfaqësimit të ndjekjes penale në gjykim, si dhe për shkelje të normave etike.

Nga hetimi disiplinor i kryer nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë mbi veprimtarinë hetimore të magjistratit në periudhën 2018-2021 u provua se magjistrati ka sjellje të përsëritur refuzuese në mosmarrjen në dorëzim të dosjeve; ka mospjesëmarrje të përsëritur në seanca gjyqësore; ka kryer përfundim të çështjeve me vendim si prokuror, pa proceduar me kalimin e tyre me kërkesë në gjykatë dhe mosnxjerrje të urdhërave për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore të dënimit me burgim.

Hetimi disiplinor i ILD provoi se nga ana e magjistratit SH.K., ka patur shkelje të përsëritur dhe të rëndë të rregullave të solemnitetit, rregullave të mirësjelljes në marrëdhëniet me palët, me drejtuesit e prokurorisë, me gjyqtarët, me oficerë të policisë gjyqësore, si dhe me personelin e administratës së prokurorisë dhe të gjykatës.

Sjelljet e magjistratit SH.K. kanë sjellë shkelje të rënda profesionale, diskretitim të pozitës dhe figurës së prokurorit, si dhe kanë cënuar besimin e publikut të drejtësisë.

Për pasojë Inspektori i Lartë i Drejtësisë kërkoi nga KLP shkarkimin nga detyra, të prokurorit SH.K. për shkeljet disiplinore të parashikuara nga neni 148/d pika 2, shkronja “a” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nga neni 102, pika 1 shkronja “b” nën-pika “ii”, neni 102 pika 1 shkronja “ç”, “d”, “dh”, “g” dhe neni 102 pika 2 shkronja “a” dhe “dh” të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve.



METANI: DUKE MBROJTUR GAZETARËT, NE MBROJMË TË DREJTËN E SHOQËRISË PËR TË GJYKUAR QEVERISJEN NË ÇDO DIMENSION

Fjala e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë Artur Metani në konferencën e zhvilluar në 16 Dhjetor: "Siguria dhe mbrojtja e gazetarëve: ndarja e standardeve dhe adresimi i sfidave të përbashkëta"

Mirëdita të gjithëve dhe faleminderit për ftesën!

Është kënaqësi, por më tepër privilegj, të jem në një tryezë të tillë, ku diskutohet mbi një temë themelore për shëndetin moral, politik e kushtetues të një shoqërie, siç është tema e sotme mbi sigurinë dhe mbrojtjen e gazetarëve dhe adresimin e sfidave të përbashkëta për një media të lirë e profesionale.

Ky është kontakti im i parë me përfaqësues të medias mbi këtë temë dhe shpresoj të mos jetë i fundit, sepse të ulesh e të flasësh, të shkëmbesh pikëpamje, edhe kur janë të ndryshme, është rruga e duhur për gjetjen e urave të përbashkëta të komunikimit, të cilat veçse i ndihmojnë punës së secilit prej nesh, tonës si institucione të drejtësisë dhe vetë medias.

Është tashmë aksiomë që liria e medias është thelbësore në një shoqëri demokratike. Liria për të folur për çështje të shoqërisë, qeverisjes dhe zyrtarëve publike është bazamenti mbi të cilin ndërtohet zhvillimi politik e shoqëror i një vendi. Por, po kaq i rëndësishëm për një shoqëri demokratike është edhe një pushtet gjyqësor dhe një sistem drejtësie i pavarur. Të dyja këto vlera, të dy këto pushtete gjejnë mbrojtje dhe garanci në Kushtetutë. Por, asnjëra me epërsi ndaj tjetrës. Dy pushtete me profile të qarta dhe të ndara, por me ngjashmëri thelbësore me njëra tjetrën. Fuqia e të dyjave varet nga besimi i publikut, nga besimi i njerëzve.

Nisur edhe kjo predispozitë e besimit të publikut, ndoshta, shpesh është thënë se vendimet gjyqësore nuk komentohen, por zbatohen. Dikur, zbatohen. Por, nuk mundet të mos komentohen. Nëse publiku nuk është i kënaqur me një vendim gjyqësor apo vendime të sistemit të drejtësisë, cdokush duhet të jetë i lirë ta thotë publikisht këtë. Për më tepër media, një pushtet i konceptuar të shprehë atë që publiku mendon. Dhe sado e vështirë të jetë apo të duket kjo gjë

mbi punën e institucioneve të drejtësisë, ata janë të detyruar të marrin vendime dhe të jenë të përgatitur që dhe do kritikohen për to, përmes raporteve apo analizave mediatike. Dhe është vitale të ndodhë kështu në demokraci dhe sistemi i drejtësisë duhet të jetë në gjendje të përballojë cdo kritikë, nëse publiku apo media ka perceptimin, se procedurat nuk shihen apo vlerësohen si të drejta.

Natyrisht, ka raste kur kritikën mund të jenë të padrejta apo në raste të vecanta edhe të pabazuara në realitetin faktik. Madje ka edhe rezerva për mangësitë e njohurive mbi punën e institucioneve të drejtësisë apo për fokusimin në sensacion dhe jo në thelbin e një çështjeje. Por, nuk është kjo çështja mendoj. Me gjithë problematikat normale të zhvillimit të saj, media mbetet burimi kryesor i informimit të publikut, është mjete kryesor i transmetimit të këndvështrimeve të ndryshme dhe mjete kryesor për të bërë që institucionet e drejtësisë të reflektojnë.

Personalisht dhe institucionalisht i qëndrojmë mendimet se liria e mass medias është thelbësore në një shoqëri demokratike, një aset që duhet garantuar e mbrojtur, edhe nga institucionet.

Nëpërmjet mbrojtjes dhe garancive që u japim gazetarëve, ne mbrojmë jo thjesht gazetarët, por misionin e tyre, të drejtën e shoqërisë për të patur mundësinë për të gjykuar qeverisjen në cdo dimension të saj. Shoqëria është dhe duhet të jetë ajo që vlerëson, nëse qeverisja apo një raportim mediatik i caktuar është korrekt dhe jo institucionet, duke kufizuar informacionin. Brenda kufizimeve të vendosura nga Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, askush nuk mund të vlerësojë rolin e medias, duke i kufizuar informacionin, duke i kufizuar mundësinë për të marrë informacion apo më keq, duke e intimiduar dhe goditur median.

Fakt është se një shoqëri mund të zhvillohet shëndetshëm, vetëm nëse anëtarët e saj, pra

qytetarët, kanë informacion të besueshëm dhe kjo varet nga puna e medias, që ua përcjell atë informacion. Këtë mund ta realizojnë gazetarët të informuar e me njohuri mbi rolin e detyrat e institucioneve të drejtësisë e magistratëve në demokraci, që raportojnë e kritikojnë patjetër, me përgjegjshmërinë e detyrimit për t'i dhënë publikut informacion të saktë, të paanshëm. Dhe jemi me fat që kemi gazetarë të tillë në Shqipëri, madje edhe në këtë tryezë.

Patjetër që ka raste, që edhe media reflekton defektet, që vetë shoqëria ka. Nuk ka si të ndodhë ndryshe në një shoqëri në zhvillim. Por zhvillimin demokratik të shoqërisë, të medias dhe të institucioneve nuk e ndihmojmë duke i vendosur kufizime, por duke e lënë të lirë debatin. Edhe kur jemi të ndjeshëm ndaj kritikave të padrejta që marrim, kjo ska rëndësi. Rëndësi ka transparenca, mundësia për debat për të drejtën dhe të vërtetën. Ky është një proces, është një zhvillim demokratik që kërkon durim dhe natyrisht kohë, por kjo është një kosto, të cilën duhet të jemi gati dhe bashkëpunues sa mundet për ta përballuar.

E dëgjoj shpesh shprehjen, që më vjen edhe në formë këshille, se “beteja me shtypin është gjithmonë e humbur”. Dhe mendoj se po. Është e humbur sepse e humbur është beteja me lirinë e shoqërisë për të parë dhe kuptuar administrimin e drejtësisë. E pikërisht në emër të interesit publik, liria e medias nënkupton të drejtën për të kundërshtuar e kritikuar dhe kjo e drejtë e saj duhet mbrojtur e garantuar. Një media e fortë dhe profesionale, padyshim që do ndikojë në përgjegjshmërinë e institucioneve tona dhe sic është po ashtu e qartë, se keqinformimi apo lajmet e rreme e gërryejnë besimin e publikut, si tek media ashtu edhe tek institucionet dhe pasojë është pengesa, që e gjithë shoqëria të ecë përpara.

Në këtë kontekst ka dhe një specifike, të cilën dua ta nënvizoj. Ekziston një dallim i rëndësishëm ndërmjet kritikave që bëhen ndaj magistratëve

dhe kritikave ndaj zyrtarëve të tjerë publikë. Magjistratët nuk mund të përgjigjen për kritikën që u bëhen, nuk mund të komentojnë për çështjet e tyre, qoftë edhe për të hedhur poshtë shtrembërimet mediatike të vendimeve të tyre. Ndryshe nga institucionet që burojnë nga politika, institucionet e pavarura dhe magjistratët e kanë këtë lloj kufizimi, që vjen me detyrën. Por, gjyqtarët dhe prokurorët, zyrtarët e institucioneve të drejtësisë nuk e kanë keqkuptimin me median, mendojnë. Beteja është me transparencën. Vërtetë magjistratët nuk mundet të shprehin apo komentojnë mbi vendimet e tyre, por nëse vendimet që ata marrin, shprehin qartë dhe pa asnjë ekuivok, thjeshtë dhe kuptueshëm, drejt dhe pa lakime, mendimin e tyre juridik dhe diskrecionin e tyre të bazuar në ligj, atëherë publiku dhe media do të jenë të qartë se çfarë u duket e drejtë dhe e padrejtë në atë vendim. Sa më të qartë të jenë gjyqtarët me vendimet e tyre, sa më të qartë të jenë ata për rolin e tyre, aq më e thjeshtë është edhe për median, të transmetojë në publik rëndësinë e kësaj vendimmarrjeje.

Sot do flasim për të rritur garancitë për ushtrimin e detyrës nga gazetarët dhe fatmirësisht në Shqipëri nuk ka raste të vrasjes së gazetarëve, sic është rasti i gazetarës së ndjerë malteze Dafne Galicia, që u soll në vëmendje në fillim të kësaj konference. Një vrasje e tipit mafioz ndaj një gazetareje që bënte detyrën, e që duhet të turpërojë çdo vend ku ndodh. Dhe padyshim që

institucionet mund të bëjnë shumë për të parandaluar ngjarje të tilla, e garantuar mbrojtjen e gazetarëve. Për këtë konferencë, konsultova disa shifra të publikuara nga Federata Ndërkombëtare e Gazetarëve, sipas së cilës 2658 gazetarë janë vrarë prej vitit 1990, 42 prej të cilëve vetëm në vitin 2020 dhe 235 gazetarë janë në burg.

Fatmirësisht nuk kemi situata të tilla në vendin tonë dhe uroj të mos kemi, por pa dyshim që janë denoncuar edhe publikisht raste intimidimi, dhune, pengimi për të bërë detyrën, sic ishte ai që u raportua së fundmi ndaj gazetares së Fax News, apo edhe padi në gjykata. Ka raste që mund të dëshmojnë edhe në këtë sallë. Janë akte që mbeten shqetësuese, e që duhet të na bëjnë të gjithëve të reflektojmë dhe të marrim masa. Perpara se të na duhet të merremi me pasojat.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka vullnetin për të bërë pjesën që i takon në mbrojtjen e garantimit të drejtës së gazetarëve për të kryer detyrën e tyre, sepse e përsëris, i qëndroj mendimit se duke mbrojtur gazetarët, ne garantojmë të drejtën e shoqërisë për të patur lirinë për të gjykuar punën e secilit në çdo dimension.

Ju faleminderit!





ILD

INSPEKTORI I LARTË
I DREJTËSISË

Inspektori i Lartë i Drejtësisë


ju uron

Gëzuar Festat!

Dhjetor 2021

Të gjitha të drejtat e rezervuara Inspektori i Lartë i Drejtësisë

© ILD



KONTAKT ILD

WEB: ild.al

EMAIL: info@ild.al

ADRESA: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Godina nr.13
Tiranë, Shqipëri



 [@Inspektori i Larte i Drejtësisë Artur Metani](https://twitter.com/Inspektori_i_Larte_i_Drejtësisë_Artur_Metani)
[@ILD_Albania](https://twitter.com/ILD_Albania)

 [Inspektori i Lartë i Drejtësisë](https://www.youtube.com/Inspektori_i_Larte_i_Drejtësisë)



Spot prezentues ILD
Prezantimi i Inspektorit të Lartë të Drejtësisë
[youtube.com](https://www.youtube.com)

[Kliko për të ndjekur spotin prezentues të ILD](#)